

Projekti i hidrocentralit të Poçemit lumi Vjosa




Vjosa në pjesën e gjerë mbi digën e Kalivaçit Foto © Gregor Subic

Vjosa (Përshkrimi & Kërcënimet)

Hidrocentralet në basenin Vjosës

- ❖ **38 HEC-e** janë parashikuar të ndërtohen në pellgun ujëmbledhës të Vjosës;
- ❖ **6 diga** të reja janë projektuar në pjesën greke të basenit ndërkohë që është vetëm një ekzistuese vetëm një, diga e madhe e Pigait.
- ❖ **31 HEC-e** në territorin Shqiptar: 8 diga janë planifikuar përgjatë vetë Vjosës ndërsa 23 HEC-e të vegjël në degët e saj, 4 nga të cilat kanë përfunduar ndërtimin, ndërsa 4 të tjera në ndërtim.



Lumi Vjosa në Shqipëri është nga të vetmit lumenj të Evropës që rrjedh në gjendje të egër. Përgjatë gjithë rrjedhës së tij në 270 kilometra ai rrjedh rrëmbyeshëm dhe i lirë në rrjedhën e sipërme dhe i qetë në rrjedhën e poshtme dhe karakterizohet nga kanione të e të ngushtë, ishuj, kthesa dhe gjarpërime. Në disa zona shtrati i lumit zgjerohet në mbi 2 km. Ajo që e bën këtë lumë të veçantë në botë është fakti, që pothuajse të gjithë degët e tij rrjedhin të lirë dhe të pa prekur, duke krijuar një rrjet të gjallë lumor që nuk haset më në Evropë.

Mungesa e një plani bilateral të menaxhimit të integruar për gjatë basenit të lumit i ka dhënë mundësinë e artë investitorëve për tu angazhuar në një “bum” ndërtimesh të shpejta hidrocentralesh në luginë. Projekti i Kalivaçit është iniciuar qysh në vitin 1997 nga një kompani italiane por punimet janë ndalur në 2007. Si rezultat, lumi mbetet i pa ndërprerë deri më sot. Të tjerë hidrocentrale të vegjël në degët e lumit janë zyrtarisht “në ndërtim”, por puna aktualisht është ndalur (p.sh. ndërtimet në lumin e Bënçës janë ndalur për 15 muajt e fundit). Rasti më urgjent është HEC i Poçemit në Vjosë. Në maj 2016 qeveria shqiptare ka miratuar koncesionin për një kompanie turke, i cili i hap udhë këtij projekti.

HEC-i Poçemit

Në maj 2016, qeveria shqiptare i ka dhënë koncesion dy kompanive Turke “Ayen Enerji Şirketi Anonymous” dhe “Çinar-San Hafriyat Nakliyat Turizm Insaat San Ve Tik Ltd.Sti” për të ndërtuar një digë të madhe në



Vjosë. Projekti “Poçem” konsiston në ndërtimin e një dige rreth 50 metra të lartë, e cila jo vetëm që do të ndikojë drejtpërdrejt në një nga seksionet më me vlerë të Vjosës për shkak të përmbytjeve, por do të sjellë problem serioze edhe në rrjedhën poshtë digës. Procedurat ligjore janë aktualisht në vazhdim, megjithatë, vlen të theksohet se informacioni në lidhje me VNM-në, Lejet Mjedisore dhe Dëgjuesat Publike lidhur pikërisht me këtë projekt është mbajtur vazhdimisht fshehur për më shumë se 7 muaj nga autoritetet përgjegjëse (Agjencia Kombëtare e Mjedisit), pavarësisht insistimit të

EcoAlbania-s për ta pasur këtë informacion. Vetëm kohët e fundit, ky informacion u bë i mundshëm. Sipas këtij informacioni VNM-ja është prezantuar gjatë konsultimeve me komunitetin në 28 Shkurt, 2015 në Fier, por komuniteti lokal dhe njësi administrative lokale e prekur nga ndërtimi i hidrocentralit nuk janë informuar. Ndërkohë që banorët kanë protestuar kundër ndërtimit.

Fakte & Shifra	
Gjatësia e digës	200 m
Lartësia e digës	50m
Madhësia e rezervuarit	23,5 km ² e zonës së përmbytur
Volumi i rezervuarit	23,5 milion m ³
Kapaciteti/ Prodhimi vjetor	102,2 MW/ 366.8 GWh
Gjatësia e digës	200 m

Burimi: Projekti i Hidrocentralit të Poçemit, raport i VNM-së

Hapat kronologjik të HEC- it të Poçemit

Në tabelën më poshtë përshkruhen hapat që janë ndjekur nga kompania dhe institucionet shqiptare si dhe afati kohor për çdo hap.

Afati Kohor	Hapat
2014	Përgatitja e studimit para- fizibilitetit
2015-Shkurt-28	Dëgjuesat Publike në Hotel Fieri në Fier, Shqipëri
2015-Mars-01	VNM paraqet Kërkesën për Lejen Mjedisore
2015-Prill-24	Deklarata Mjedisore lëshuar nga (MMj)
2015-Korrik-29	Qeveria Shqiptare aprovon 8% nga 10% maksimale të bonusit për kompaninë turke Çinar-San në lidhje me ndërtimin e HEC-it të Poçemit
2016-Shkurt-01	MEI shpall hapjen e tenderit në lidhje me ndërtimin e HEC-it të Poçemit
2016-Maj-09	MEI shpall fituesin e këtij tenderi që janë dy kompanitë turke

Përpyekjet

Në kuadër të fushatës “Të shpëtojmë zemrën blu të Evropës” përgjatë 2 vjetëve janë ndërmarrë shumë aksione lidhur me mbrojtjen e lumit Vjosa nga “cunami” i ndërtimit të hidrocentraleve.



Protestë në luginë kundër HEC-it të Poçemit Maj 2016 © Matic Oblak

Letra zyrtare

Janë dërguar 3 letra tek MEI ku kërkohen takime dhe informacione në lidhje me projektin e hidrocentralit të Poçemit dhe nuk është marr asnjë përgjigje. Nga ana tjetër janë dërguar letra edhe tek MEI, MMJ, AKM dhe AKBN ku është kërkuar informacion lidhur me HEC-in e Poçemit. Përgjigjet e këtyre letrave ose nuk kanë informacion ose informacioni i dhënë nuk i përkon asaj që kërkohet.

Protesta

Për shkak të mungesës së informacionit shoqëria civile së bashku me komunitetin lokal, gjithashtu edhe me mbështetjen e OJF-ve ndërkombëtare kanë zhvilluar disa protesta gjatë 10 muajve të fundit. Janë bërë 7 protesta publik, megjithatë ende nuk është i qartë vendimi në lidhje me projektin e Poçemit.

Mbulimi në media

Gjatë 10 muajve të fundit kanë qenë rreth 70 prezencat në media që kanë trajtuar problematikat e ndërtimit të hidrocentraleve në basenin e lumit Vjosa. Mbulimi mediatik ka qenë mjaft inkurajues duke qenë se lajmet lidhur me këtë çështje janë pasqyruar nga mediat që nga SHBA-ja deri në Japoni duke përfshirë dhe shumicën e mediave më të rëndësishme Evropiane si edhe ato Shqiptare.



Protestë në Tiranë kundër HEC-it të Poçemit Maj 2016 © Andrew Burr

Ankesa në Konventën e Bernës

Përveç përpjekjeve në ndërtimin e kanalit të komunikimit me vendim-marrësit në Shqipëri në lidhje me hidrocentralet në Vjosë, në korrik 2016, EcoAlbania ka dërguar një ankesë zyrtare në adresë të Komunitetit të Përhershëm të Konventës së Bernës. Në ankesë përveç hidrocentralit të Poçemit që ka një rëndësi të veçantë, është përgatitur një raport 5 faqesh për vlerësimin e ndikimit të hidrocentralit në biodiversitetin e luginës.

Lobimi (Rezolutat e PE)

Presioni ndërkombëtar në lidhje me zhvillimin e hidrocentraleve në luginën e lumit Vjosa është vazhdimisht në rritje. Në dy rezolutat e fundit Parlamenti Evropian përmend në mënyrë eksplicite Vjosën ndërsa i ka sugjeruar qeverisë shqiptare që të rishikojë edhe njëherë të gjitha projektet e hidrocentraleve në basenin e lumit Vjosa pasi ky lum konsiderohet i një rëndësie të veçantë për natyrën Evropiane.

VNM & Dëgjesat Publike

I ashtuquajturit raport i "thelluar" i VNM-së për HEC-in e Poçemit është përgatitur nga kompania shqiptare për konsulencë mjedisore Gr Albania, e cila është e certifikuar për të hartuar të tilla raporte. Si rezultat i punës së tyre është një raport prej 100 faqesh, të cilin në Mars 2015 pas paraqitjes së tij

tek komunitetet e interesuara si pjesë e procesit për konsultimin me publikun, është paraqitur pranë AKM, së bashku me kërkesën zyrtare për aprovimin e Deklaratës Mjedisore. Sipas Deklaratës Mjedisore ky raport ishte përgatitur sipas procedurave, por menjëherë pasi ky informacion është bërë i mundur, është ngritur një grup i pavarur ekspertësh për të përgatitur një raport analize mbi raportin e VNM-së. Puna po vazhdon edhe në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë, por është e rëndësishme të bëhen publike gjetjet më kryesore të këtij raporti analitik mbi VNM-në.

Gjetjet kryesore:

- Procedura e ndjekur gjatë përgatitjes së raportit të VNM-së NUK është në përputhje me legjislacionin aktual shqiptar.
- Struktura, fjalët dhe informacioni që përmban raporti NUK është siç është kërkuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave (Aneksi II, VKM 686)
- Plani i punës dhe kohëzgjatja e punimeve, kohëzgjatja e fazës së operimit, rehabilitimi, mungojnë në raportin e VNM-së;
- NUK ka informacion në lidhje më të tjera projekte ekzistuese përreth/afër zonës së projektit dhe NUK është bërë asnjë analizë për ndikimet kumulative të tyre.
- NUK ka asnjë informacion lidhur me analizën e alternative për aq kohë sa alternativa e ndërtimit të HEC-it qëndron e vetme në këtë raport, pa marrë në konsideratë alternativa të tjera zhvillimi për zonën.
- NUK ka referenca në lidhje me informacionin e përdorur.
- VNM-ja konstaton një paaftësi të theksuar profesionale dhe një njohuri jashtëzakonisht të limituar nga ana e autorëve për zonën e studimit ku do të ndërtohet hidrocentrali.
- Ekspertët mjedisor që kanë përgatitur VNM NUK i njohin konceptet e "habitat" dhe "ekosistem". Për këtë arsye në raportin e VNM-së nuk ka vlerësime të bëra për habitatet e pranishme të florës dhe faunës. Edhe në ato pak raste që janë përpjekur të identifikojnë speciet ose habitatet, emërtimi i tyre është i gabuar.
- Raporti pasqyron dukshëm mangësitë e autorëve në ndërtimin e fjalive aq sa shumë fjali nuk kanë kuptim. Kjo ka ardhur si pasojë e mbi-përdorimit të "copy-paste".
- Raporti i VNM-së është ë fakt një amalgamë raportesh të tjera të VNM-ve që i përkasin projekteve të tjera të ngjashme të shtrira në të gjithë vendin. Kjo VNM është të paktën 60% plagjiaturë nga të tjera dokumente.
- VNM është fokusuar në përshkrime të përgjithshme të situatës dhe nuk ka një analizë të saktë dhe një vlerësim të ndikimit të detajuar, si pasojë nuk ka analiza për ndikimin që do të ketë ndërtimi i këtij HEC-i në turizëm, peshkim dhe sipërfaqen pyjore.
- Plani për zbutjen e ndikimeve është paraqitur në nivele shumë empirike, pasi analizon vetëm parametrat fiziko-kimikë ndërkohë që nuk parashikon një monitorim të treguesve biotikë.

Konsultimet me Publikun

Konsultimet me publikun në lidhje me projektin e hidrocentralit të Poçemit u zhvilluan në Hotel Fieri në Fier më 28 Shkurt 2016. Megjithëse ishin rreth 50 pjesëmarrës në këtë takim, përsëri është shkelur VKM për Informimin dhe Konsultimin me Publikun.

- Asnjë nga ë pranishmit në këtë konsultim nuk është nga zona e prekur (Bashkia Mallakastër e cila përfshin fshatrat Kutë, Poçem, Çorrush, Anëbreg, Drizar dhe Bashkia Selenicë që përfshin fshatrat Shkozë, Sevaster dhe Karabonarë).
- Njësitë e qeverisjes vendore NUK janë informuar për mbajtjen e këtij konsultimi me publikun.
- Janë evidentuar pasaktësi në listën e pjesëmarrësve dhe çështjet e ngritura gjatë konsultimit.
- Procesi i njoftimit të konsultimit me publikun është i mangët pasi nuk ka pasur pjesëmarrje nga asnjë OJF. Ndërkohë që pjesa më e madhe e pjesëmarrësve janë pjesë e administratës

publike të Fierit e të Njesisë Administrative Portëz.

- NUK ka një dokument protokollar lidhur me komentet e publikut prandaj dhe NUK ka reagim për këto komente nga kompania.

Kërkesat



Rrjedha e sipërme e lumit Vjosa © Egmundt Strigl

Baseni i Lumit Vjosa ka një rëndësi të veçantë në trashëgiminë natyrore të kontinentit Evropian, përveç kësaj është dhe një mundësi unike për studimet e shkencave lumore. Prandaj ideja e përcaktimit të të gjithë luginës si një “zonë e ndaluar” për ndërtimin e hidrocentraleve është një opsion dhe një kërkesë për vendim-marrësit në Shqipëri. Megjithatë në mënyrë të veçantë në lidhje me projektin e hidrocentralit të Poçemit kërkesat kryesore janë:

- **Një raport realist VNM sipas standardeve të BE përpara se të ndërhyhet për ndërtim.**
- **Një tjetër Konsultim me Publikun ku komunitetet e prekura të jenë pjesë.**
- **Përpara se të fillojnë ndërtimet dhe dhënia e koncesioneve të tjerë, vendosja nën një moratorium për 3 vjet duke i lënë hapësirë studimeve shkencore për të gjithë sistemin e lumit Vjosa.**
- **Në vend të ndërtimit të digave shpalljen e Parkut të parë Kombëtar të lumit të egër të Evropës.**

Më shumë informacion:

www.ecoalbania.rog

www.balkanrivers.net

[Olsi Nika | o.nika@ecoalbania.org](mailto:o.nika@ecoalbania.org)

[Cornelia Wieser | cornelia.wieser@riverwatch.eu](mailto:cornelia.wieser@riverwatch.eu)

[Theresa Schiller | thesa.schiller@euronatur.org](mailto:theresa.schiller@euronatur.org)

Lumenjtë e Ballkanit janë ndër më të mbrojturit në të gjithë Evropën. 80% e gjithë lumenjve të Ballkanit janë ose në gjendje shumë të mirë ose të mirë hidro-morfologjike. Megjithatë, kjo trashëgimi natyrore evropiane është në rrezik. Janë rreth 2700 projekte hidrocentralesh të planifikuara nga Sllovenia në Shqipëri. OJF-të Riverwatch dhe EuroNatur kanë nisur fushatën ndërkombëtare “Të Shpëtojmë Zemrën Blu të Evropës” në bashkëpunim me disa organizata partnere lokale, si EcoAlbania në Shqipëri.



euRONATUR

RiverWatch

EcoAlbania